



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:047635

Datë: 12.07.2019

Numri i dokumentit: 00406330

P.nr. 1014/16

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit K. B. H. nga fshati P., për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par. 1 të KP, e duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren PP.II.nr. 2964-7/16 të dt. 27.12.2016, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 11.07.2019, në prezencë të PSH Atnor Skoro, të akuzuarit, muarrë dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 12.10.2019 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari K. H., nga i ati B., i lindur me dt.01.01.1990, jeton në fsh.P., i martuar, baba i dy femijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes jo të mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Me datë 23.10.2016 rreth orës 11,00 në vendin e quajtur “G.” njësia menaxhuese “Koka e Ahut” me qëllim të vjedhje në pyllin publik, i pandehuri ka prer me motorsharr dru të njoma të llojit 2ahu” me diametër 14-15 cm, me vëllim të pergjithshëm prej 5.15 m<sup>3</sup>, të cilat i ka bartur me automjetin Kombi “Favo Hint” e qe është hasur nga roja e pyllit, me çrast Drejtoris per Zhvillim Bujqësi dhe Pylltari në Suharekë i shkakton dëm material në vlere prej 787.95 euro.

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par. 1 të KP.

Gjykata në kuptim të nenit 41,43,51,52,73,74,si dhe nenit 358 par. 1 të KP, të akuzuarit, ia shqipton:

**DENIMIN ME KUSHT**

Të akuzuarit K. H. gjykata i shqipton dënim me burgi në kohëzgjatje prej 3 muaj, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej një viti, nga dita e plotëfuqishmeris së këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ dhe taksës për kompenzim të viktimave të krimit shumën prej 30 €, të gjitha këto pas plotëfuqishmeris se këtij aktgjykimi.

E dëmtuara Komuna e Suharekës, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil

## A r s y e t i m

PTH në Prizren me aktakuzën PP.nr. 2964-7/16 të dt. 27.12.2016, ka akuzuar K. B. H. nga fshati P., për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par. 1 të KP, aktakuzën të cilën gjatë séancës gjyqësore prej fillimit gjer në mbarimin e saj e ka përfaqësuar PSH Atnor Skoro, i cili në tërsi ngel pranë të dhënave si në aktakuzë, i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.11.07.2019 dhe në vetë pranimin nga ana e të akuzuarit, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi është vërtetuar se me dt. 23.10.2016 rreth orës 11,00 në vendin e quajtur “G.” njësia menaxhuese “Koka e Ahut” me qëllim të vjedhje në pyllin publik, i pandehuri ka prer me motorsharr dru të njoma të llojit “Zahu” me diametër 14-15 cm, me vëllim të pergjithshëm prej 5.15 m<sup>3</sup>, të cilat i ka bartur me automjetin Kombi “Favo Hint” e qe është hasur nga roja e pyllit, me çrast Drejtoris për Zhvillim Bujqësi dhe Pylltari në Suharekë i shkakton dëm material në vlere prej 787.95 euro.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtim gjyqësor e ka pranuar fajsin.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 259 të KPP në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe poashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsis, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht në shqyrtimin gjyqësor, pranimi është mbështetur në faktet e qështjes që përmban aktakuza, siq janë, fletparaqitja e rojtarit te pyllit me nr. 282/16 të dt. 11.11.2016, kërkesa e Drejtoris për zhvillim bujqësi dhe pylltari, dhe shkresat e tjera të cilat gjinden ne lëndë.

Gjykata poashtu në tërsi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajsis në shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248 nga se nuk egziston ndonjë nga arsyerat dhe kushtet për hudhjen e aktakuzes, apo pushimin e procedurës penale si dhe nenit 253 te KPP. Dhe nga këto fakte të cilat i përmban aktakuzes, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimin e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qënjes së veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par. 1 të KP, gjykata ka vendosur të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ia shqiptoi dënimin siqë është cek në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ka vlersuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KP.

Gjykata si rrethanë letësuese pati parasyshtë se i akuzuari ka patur qëndrim korrekt ndaj gjykatës, i pa punë, i gjendjes se varfër ekonomike, është pendu për veprën e kryer, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, kurse rrethanë rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesen pasuroro juridike u muarrë në kuptim të nenit 463 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 452 par.1 të KPP.

Vendimi me të cilin është i obliguar i akuzuari që të bëjë kompenzimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr. 1014/16 të dt. 11.07.2019**

Sek. Juridike  
F. Kabashi

G j y q t a r i  
Robert Tunaj

**UDHËZIME JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, llogaritur nga dita e paranimimit të tij ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftushme për palët dhe gjykatën.